

NJOFTIM MBI REZULTATIN E VERIFIKIMIT NË KATEGORINË E MESME DREJTUESE

Njësia Përgjegjëse pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Kreu V – “Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë”, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, në përfundim të afatit për pranimin e dokumenteve, si dhe të verifikimit paraprak të kandidatëve për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të veçanta për ngritjen në detyrë, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, njofton se për pozicionin:

- 1 (një) - “Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit të Ankesave, në Drejtorinë e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit, pranë KDIMDP-së”, Kategoria II-1

Kandidati i kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrit është:

- Roland Stafa (ngritje në detyrë)

A. Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën 13.03.2026, ora 09:00, në ambientet e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, adresa: Rr. “Abdi Toptani”, Nd. 5, Tiranë.

B. Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet pas testimit me shkrim.

Njësia Përgjegjëse